



This project is funded
by the European Union



RREGULLORE PËR KOMUNIKIM PLATFORMA PËR INVESTIME NË KOMUNITET (CIP)

PËRBMAJTJA

I.	Parime të përgjithshme për komunikim	2
II.	Veglat për komunikim.....	2
III.	Shfrytëzimi i veglave për komunikim	2
3.	Mënyra e vendimmarrjes përmes formës elektronike	3

I. Parime të përgjithshme për komunikim

- Secila anëtare e platformës i ndan informatat relevante për punën e platformës në mënyrë të barabartë deri te të gjitha anëtarët. Përjashtim bën vetëm kur shpërndahen dokumente pune të trupave të platformës ku informatat ndahen mes të gjitha anëtareve të këtij trupi;
- Informatat deri te anëtarët duhet të distribuohen me kohë, që të mundësohet informatë kthyesë adekuate nga anëtarët. Anëtarët do t'i respektojnë afatet e caktuara për informatë kthyesë në pajtim me rregulloret për punë të platformës. Nëse anëtarja nuk përgjigjet, do merret si përgjigje pozitive;
- Anëtarët e platformës do të komunikojnë mes tyre me respekt ndaj organizatave dhe personave të cilët i përfaqësojnë;
- Informatat e ndara në kuadër të platformës nuk do të keqpërdoren për qëllime personale dhe komerciale (vërejtje: nevojitet të përcaktohet mënyra e shfrytëzimit të informatave për kompanitë);
- Rrjeti do të komunikojë në mënyrë transparente dhe me përgjegjësi ndaj opinionit të gjerë dhe mediave;
- Anëtarët e rrjetit janë përgjegjëse për cilësinë dhe gjuhën e informatave të cilat do të distribuohen përmes veglave për komunikim;
- Komunikimi do të zhvillohet në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe. Sekretariati do të kujdeset të sigurojë përkthim atje ku do të ketë nevojë.

II. Veglat për komunikim

Rrjeti do t'i zhvillojë dhe do t'i përdorë këto vegla për komunikim:

- Lista për distribuim të informatave (komunikim elektronik dhe i shkruar);
- Posta elektronike
- Ueb platforma/portali
- Faqe e Facebook
- Grup në Viber
- Skype

Po ashtu rrjeti do të komunikojë me opinionin edhe përmes mediave të shkruara dhe elektronike.

III. Shfrytëzimi i veglave për komunikim

1. Veglat për komunikim do të shfrytëzohen për këto qëllime:

- Ndarja e informatave nga fusha e punës së platformës;
- Ndarja e materialeve resurse me interes të anëtareve;
- Koordinim i aktiviteteve të platformës;
- Miratimi i vendimeve të organeve dhe trupave të platformës;
- Realizimi i procedurave të platformës në pajtim me rregulloret e miratuara për punë;

- Miratimi i propozimeve për aktivitetet dhe iniciativat e platformës;
- Informimi dhe promovimi i punës së platformës në opinion;
- Avokimi dhe lobimi për çështje relevante për sektorin civil;
- Qëllime tjera relevante për funksionim efikas të platformës.

2. Veglat për komunikim të rrjetit nuk do të shfrytëzohen për:

- Zgjidhja e konflikteve ndër personale dhe organizative mes dy ose më shumë anëtareve të platformës që nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë me punën e platformës;
- Ndarja e informatave që nuk janë relevante për punën e platformës;
- Lobimi për parti politike;
- Promovimi i aktiviteteve të bashkësive fetare, të cilat drejtpërdrejtë nuk janë të lidhura me aktivitete të caktuara të platformës;
- Avokimi dhe realizimi i interesave personale të cilat janë në kundërshtim me interesat e platformës;
- Promovimi i interesave të organizatave individuale të cilat janë në kundërshtim me interesat e platformës.

3. Mënyra e vendimmarrjes përmes formës elektronike

Gjatë punës aktuale të trupave dhe organeve të platformës, për shkaqe praktike shumë shpesh vendimet do të miratohen përmes formës elektronike. Në këtë rast procedura realizohet në këtë mënyrë:

- Nëse ekziston informatë ose propozim për të cilin platforma duhet të deklarohet, anëtarja e cila e ka informatën e dërgon deri te Sekretariati i platformës (për momentin Fondacioni Albiz);
- Sekretariati e ndan këtë me Këshillin drejtues, i cili e shqyrton informatën dhe e përcjell me propozim për votim deri te të gjitha anëtarët e platformës, përmes postës elektronike;
- Mesazhi me informatën për votim duhet të përmbajë afat brenda të cilit duhet të deklarohet anëtarja dhe atë:
 - Për votim për anëtar në trupat dhe organet – afat prej 10 ditë kalendarik
 - Për komente rreth dokumenteve të rrjetit – afat prej 3 deri 10 ditë varësisht nga urgjenca, madhësia dhe rëndësia e dokumentit
 - Për zgjedhje të përfaqësuesve të platformës në konferenca, trajnime, trupa ndër-sektorial etj. – vendimin e sjell Këshilli drejtues në pajtim me Rregulloren për punë dhe do t'i informojë anëtarët.
- Nëse organizata-anëtare nuk deklarohet në afatin e caktuar, merret se përgjigja është pozitive, do të thotë se dokumenti është miratuar. Në rast të votimit mes më shumë personave (përveç në rastet kur zgjidhen anëtarë të trupave për të cilat nevojitet deklarim i minimum 50%+1 anëtar) merret se zgjedhja është kryer në bazë të shumicës së votave nga anëtarët të cilat kanë votuar.